



UNIVERSITETI I PRIZRENIT

UNIVERSITY OF PRIZREN

„Ukshin Hoti“
Rektorati

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Rektor
Prof. Dr. Ramë Vataj

Nr. i ref. 01- 1435

Prizren, më 30. 10. 2014

Mbështetur në dispozitat e nenit 48 pika 1.14 të Statutit të UPZ-së, nr. 04 -V- 621 dt. 30.maj 2013, e në përputhje me kompetencat që ka, Senati i Universitetit të Prizrenit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.10.2014 merr këtë:

V E N D I M

Mbi kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve për vitin akademik 2014/2015

- I. Studentët e vitit të parë, për të zënë kushtin e regjistrimit të vitit të dytë të studimeve duhet të kenë dhënë 70% të provimeve ose të kenë fituar 42 kredi (ECTS).
- II. Studentët e vitit të dytë, për të zënë kushtin e regjistrimit të vitit të tretë të studimeve, duhet të kenë dhënë 35% të provimeve, ose të kenë fituar gjithsej 20 kredi (ECTS).
- III. Studentët e vitit të tretë, për të zënë kushtin e regjistrimit të vitit të katërt të studimeve, duhet të kenë dhënë 30% të provimeve, ose të kenë fituar 18 kredi (ECTS).
- IV. Studentët nuk mund të hyjnë në provime të vitit të dytë, pa i përfunduar në tërësi provimet e vitit të parë, gjithashtu studentët e vitit të dytë nuk mund të hyjnë në provimet e vitit të tretë, pa i përfunduar në tërësi provimet e vitit të dytë si dhe studentët e vitit të tretë nuk mund të hyjnë në provime të vitit të katërt, pa i përfunduar në tërësi provimet e vitit paraprak.
- V. Statusi i studentit të rregullt mbahet brenda dy viteve. Në bazë të kërkesës së arsyeshme të studentit, ai ka të drejtë një herë të kërkojë që t'i vazhdojë kohëzgjatja e studimeve edhe për një vit. Nëse Senati merr vendim pozitiv, atëherë studentit duhet të bëjë pagesën sa trefishi i tarifës së përcaktuar të pagesës për studentë të rregullt.
- VI. Ky vendim do të zbatohet nga data 1.10.2014
- VII. Vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Të njoftohen:

1. Menaxhmenti i UPZ-së;
2. Dekanët e Fakulteteve;
3. Shërbimi i studentëve;
4. Studentët e UPZ-së;
5. Arkivi.



Kryetari i Senatit të UPZ-së

Prof.dr. Ramë Vataj